



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 414 Prot.

Tiranë, më datë 06.08.2018

VENDIM

Nr. 371, datë 27.07.2018

PËR

VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me V.K.M. Nr. 756, datë 26.10.2016, si dhe Kodit të Proçedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.07.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e vazhdimit të proçedurave të legalizimeve për objektin: “Shtesë anësore 1 kat në godinë ekzistuese 1 kat + podrum”, Lagjja 7, Rruga “Sami Pojani”, brenda kufirit të Zonës së mbrojtur të qytetit Korçë, kërkesë e Z. Spiridhon Mihallaq Kerkeku;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Daniel Pirushi

KRYETAR

Mirela KUMBARO FURXHI

